

VENDIM
Nr. 455, datë 10.6.2020

**PËR KRITERET DHE MASËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS
DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura që, për shkak të detyrës, emërohet ose transferohet larg vendbanimit dhe nuk është trajtuar me banesë ose me kredi nga Ministria e Mbrojtjes dhe kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese deri në 3 (tre) vjet.

2. Masa e kompensimit të qirasë së banesës të jetë:

a) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit garsoniere, kur është beqar ose i martuar dhe pa fëmijë;

b) 70 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 1+1, kur është i martuar dhe ka një fëmijë;

c) 80 për qind të çmimit mesatar mujor të tregut, për qira banese, të tipit 2+1, kur është i martuar dhe ka më shumë se një fëmijë.

3. Çmimi mesatar i qirasë së banesës përcaktohet çdo vit, me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit të Mbrojtjes.

4. Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, që përfiton kompensim për qira banese, duhet të paraqesë pranë strukturës ushtarake përkatëse këto dokumente:

a) Kërkesën për kompensimin e qirasë së banesës;

b) Certifikatën personale, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake;

c) Certifikatën familjare, nëse nuk gjenerohet nga vetë struktura ushtarake;

ç) Kontratën e qirasë së banesës, të noterizuar;

d) Vërtetimin përkatës se nuk është trajtuar me banesë apo me kredi nga Ministria e Mbrojtjes;

dh) Vërtetimin përkatës se ai/ajo ose pjesëtarët e familjes nuk kanë banesë në pronësi.

Këto dokumente rifreskohen çdo vit.

5. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura gëzojnë të drejtën e kompensimit financiar në vlerë në lekë, për trajtimin me ushqim vetëm për vaktin e drekës, sipas vendimit nr. 88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", për ditët efektive të punës.

6. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, në rastet kur thirren në repart për nevoja shërbimi, ruajtjeje, gatishmërie, stërvitjeje ose fushimi mbi 8 orë, trajtohen me ushqim të gatuar ose kompensohen në vlerën në lekë të këtij ushqimi, aty ku nuk është i mundur ofrimi i këtij shërbimi, sipas normës së përcaktuar në vendimin nr. 88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

7. Përzgjedhja e formës së trajtimit me ushqim ose e kompensimit në vlerë në lekë për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, sipas pikës 6, të këtij vendimi, përcaktohet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

8. Masa e vlerës për kompensimin e ushqimit përcaktohet çdo vit me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në bazë të kostos së ushqimit të gatuar dhe të vlerës kalorike të përcaktuar në vendimin nr. 88, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.7.2004, “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 668, datë 7.8.2013, “Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama